



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
 AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
 THE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



DATË/A:	16.03.2023
REFERENC-Ë:	AKK-DPKI-06-2074/22
PËR/ZA/TO:	Arbnore Gjinovci, Zyrtare Ligjore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve
CC:	z. Sokol Shashivari, Anëtar i Këshillit për Raportim Financiar znj. Vlora Berisha, Anëtare e Këshillit për Raportim Financiar znj. Mejreme Krasniqi - Sadiku, Anëtare e Këshillit për Raportim Financiar
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Yll Buleshkaj, Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit
NGA/OD/FROM:	Esad Ejupi, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit
TEMA/SUJEKAT/SUBJECT:	Opinion për shqyrtimin e konfliktit të interesit

E nderuar znj Gjinovci,

Në mbështetje të nenit 21, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5, të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Agjencia në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive të saj ligjore, ofron këshillim për zyrtarët të lartë të veçantë, udhëheqësve, institucioneve udhëheqëse, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, përfshirë këshillime të veçanta për personat zyrtarë sipas këtij ligji pasi të jenë shteruar mjetet e brendshme në institucionet punëdhënëse dhe kur gjykohet e domosdoshme përfshirja e Agjencisë.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, fillimisht, ka pranuar kërkesë për shqyrtimin e rastit të konfliktit të interesit nga Vlora Berisha, zv. Prodekanë në Fakultetin e Biznesit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, pas kësaj është parashtruar kërkesë për shqyrtimin e konfliktit të interesit nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar, përmes autoritetit përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Agjencia, e ka hapur rastin për shqyrtimin e konfliktit të interesit, dhe i ka trajtuar zyrtarët e lartë publik, të cilët ushtrojnë funksionet në detyrë të Anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar.

Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar ka ngritur pretendimet si në vijim;

1. Sokol Shashivari – Anëtar i KKRF-së, përfaqësues i Bankes Qendrore të Kosovës, Projekt menaxher për alokimin dhe përshtatjen e kornizës rregullative, raporteve me IRFS.
2. Vlora Berisha – Anëtare e KKRF-së, si përfaqësuese nga Universiteti Haxhi Zeka, njëkohësisht ushtron edhe funksionet prof. asistent në Fakultetin e Biznesit, zëvendës Prodekanë për Infrastrukturë, Buxhet dhe Financa në Fakultetin e Biznesit.
3. Mejreme Krasniqi – Sadiku, Anëtarë e KKRF -së si përfaqësuese nga Shoqata profesionale e kontabilitetit (SHKÇKA, IKAF, IAAAB) dhe njëkohësisht Udhëheqëse e Departamentit për shërbime të Përgjithshme në IKAF.
4. Sadik Berisha –Anëtar i KKRF-së, përfaqësues nga Oda Ekonomike, Auditor Ligjor dhe njeri nga Partneret në RSM Kosovo shpk dhe RSM Albania Sh.p.k, i angazhuar në menaxhimin e projekteve të ndryshme të auditmit, taksave dhe konsulences.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, duke u bazuar në Ligjin nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ju njofton si në vijim;

1. Zyrtari i lartë z. Sokol Shashivari, Anëtar i KKRF së, si përfaqësues i Bankes Qendrore të Republikës së Kosovës, Projekt Menaxher për alokimin dhe përshtatjen e kornizës Rregullative raporteve me IRFS.

Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, me vendimin nr. 20-07/2017 të datës 06.04.2017, kishte themeluar grupin punues për përgatitjen e kornizës rregullative dhe raportuese në drejtim të përafrimit me standardin ndërkombëtar të raportimit financiar (SNFR) 9, Kryesues i këtij Grupi Punues ishte Sokol Shashivari. Me këtë vendim përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e këtij Komisioni.

z. Shashivari, në Banken Qendrore të Republikës së Kosovës e ushtron funksionin Udhëheqës i Divisionit për mbikëqyrje në vend.

z. Sokol Shashivari, aktualisht është Udhëheqës i Divisionit për mbikëqyrje në vend dhe Anëtar i KKRF së, si përfaqësues i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Funksioni Udhëheqës i Divisionit për mbikëqyrje në vend, nuk hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik sipas Ligjit nr.08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave.

Ushtrimi i funksioni Udhëheqës i divisionit për mbikëqyrje në vend dhe njëkohësisht Anëtar i Këshillit për Raportim Financiar si i deleguar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës nuk është i ndaluar me Ligjin nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Angazhimi i z. Shashivari si kryesues i grupit punues për përgatitjen e kornizës rregullative dhe raportuese në drejtë të përafrimit me standardin ndërkombëtar të raportimit financiar (SNFR) 9, nuk paraqet situatë të konfliktit të interesit.

2. Zyrtarja e lartë znj. Vlora Berisha, është emëruar si Anëtare e Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar në pajtim me nenin 21 pika 1.2. të Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Funksioni zv. Prodekane në Fakultetin e Biznesit të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë dhe funksioni Anëtar i Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar, hyjnë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik sipas Ligjit nr.08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhë Dhuratave.

Në nenin 3 pika 1.3 të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit shprehimisht thuhet;

Zyrtar i lartë – nënkuption zyrtarët e lartë publike të përcaktuar sipas Ligjit përkatës për deklarimin, kontrollin dhe prejardhjen e pasurisë.

zpj. Vlora Berisha, duke qenë zyrtare e lartë publike – Zv. Prodekan në Fakultetin e Biznesit të Universitetit “Haxhi” Zeka në Pejë, mund të ushtroj edhe funksionin Anëtare e Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar, me kufizimin e përcaktuar në nenin 13 paragrafi 2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit, në të cilin shprehimisht thuhet;

2. Zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve të tjera publike, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj. Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të.

Sipas kësaj Dispozite ligjore, zyrtarja e lartë znj. Berisha, për ushtrimin e funksionit Anëtare e Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar, nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç shpenzimeve të udhëtimit , dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të.

Shpenzimet e udhëtimit duhet të llogariten nga institucioni në pajtim me koston e shpenzimeve të krijuara gjatë kryerjes së këtij funksioni.

3. Mejreme Krasniqi – Sadiku, është emëruar Anëtare e KKRF -së si përsaqësuese nga Shoqata profesionale e kontabilitetit (SHKÇKA, IKAF, IALB).

Instituti për Kontabilitet, Auditim dhe Financa është organizatë joqeveritare e themeluar sipas Ligjit nr.03/L-136 për Lirinë e asociiimit në organizatat joqeveritare. Duke u bazuar në statutin e Institutit për Kontabilitet, Auditim dhe Financa, Organet e organizatës joqeveritare janë të përcakruar si në vijim; Asambleja e Gjenerale, Bordi i Drejtorëve, Drejtori Ekzekutiv apo Kryeshefi Ekzekutiv i IKAF si dhe Arkatari.

Ajgencia për Parandalimin e Korrupsionit, lidhur me këtë rast ka kërkuar dhe pranuar dokumentacionin relevant nga Ministria e punëve të brendshme dhe Administratës Publike.

Përfaqësues i Autorizuar - drejtor i Institutit për Kontabilitet, Auditim dhe Financa është B.K.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit lidhur me Institutin për Kontabilitet, Auditim dhe Financa, është konstatuar se ushtrimi i funksionit Anëtarë c Këshillit për Raportim Financiar dhe njëkohësisht Udhëheqëse c Departamentit për shërbime të Përgjithshme në IKAF, nuk është në kundërshtim me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit.

4. Zyrtari i lartë, Sadik Berisha, është trajtuar për situatë të konfliktit të interesit, në ushtrimin e funksionit publik. Rasti është mbyllur me shmangje të konfliktit të interesit për shkak se zyrtari i lartë ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksionit Anëtar i Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar. Ajgencia, do të bashkangjet kësaj shkrese, vendimin e nxjerrë për z. Sadik Berisha.

Ajgencia për Parandalimin e Korrupsionit, ju falënderon për bashkëpunimin.

